U0081625


# BUJKU

E HËNË, 23 NËNTOR 1998

E PËRDITSHME INFORMATIVE E PAVARUR E SHAGB "RILINDJA" PRISHTINË

Çmimi

| | |
|---|---|
| Gjermani | 2.30 DM |
| Zvicër | 2.30 SFR |
| Austri | 19 ATS |
| Çeki | 55.00 CZK |
| Luksemburg | 55.00 LF |
| Holandë | 3.50 HLF |
| Belgjikë | 55.00 BFR |
| Francë | 10.50 FF |
| Kosovë | 2.50 DIN |


DJE NË SHQIPËRI

## U mbajtën votimet për Kushtetutën

*Gjatë votimit të draftit kushtetues është parapa të marrin pjesë, 1 milion e 929 mijë e 813 zgjedhës, shifër kjo që është pranuar zyrtarisht. Në të gjithë Shqipërinë zgjedhësit kanë votuar në 4583 qendra votimit, të cilat janë shpërndarë në të 36 rrethet e vendit*



Tiranë, 22 Nëntor, /ENTER/

Sot, Ditën e diele në orën 07.00 është hapur procesi i referendumit për kushtetutën në të gjithë Shqipërinë. Gjatë votimit të draftit kushtetues është parapa të marrin pjesë 1 milion e 929 mijë e 813 zgjedhës, shifër kjo që është pranuar zyrtarisht. Në të gjithë Shqipërinë zgjedhësit kanë votuar në 4583 qendra votimit, të cilat janë shpërndarë në të 36 rrethet e vendit. Sipas statistikave të përgjithshme për mbarëvajtjen e procesit të votimit janë ngritur 64 komisione në bashki dhe 309 komuna. Votimi për kushtetutën vëzhgohet nga 200 përfaqësues të OSBE të cilët do të shpërndahen në të gjithë vendin, si edhe nga 1400 vëzhgues nga Shoqata për Kulturë Demokratike e cila ka marrë përsipër të nxjerrë edhe ajo rezultatet e referendumit. (faqe 8)

Në kërkim të një kulmi për jetë në dimrin e madh të Kosovës. Drenicë - Vasilevë, 22 nëntor 1998 (Foto Z. Bekolli)



MINISTRI AUSTRIAK VOLFGANG SHYSEL, AMBASADOR DHE KRYESUES I RADHËS NË BE

## Java e ardhshme - vendimtare për Kosovën

Sarajevë, 22 nëntor

Ministri austriak i Punëve të Jashtme dhe kryesuesi i radhës së BE-së Volfgang Shysel deklaroi gjatë bisedës së sotme në Bosnjë se Kosova momentalisht është në qendër të vëmendjes së komunietit ndërkombëtar. Java e ardhshme do të jetë vendimtare për fillimin e zgjidhjes së çështje së Kosovës, deklaroi Shysel duke mos dhënë shpjegime më të hollësishme se çka pret nga java e ardhshme. (RIPRESS)

NË NËNZONËN OPERATIVE TË LLAPIT

## UÇK-ja arrestoi një grup banditësh e kolaboracionistësh

*Është arrestuar edhe organizatori kryesor, Goran Iliq, inspektor i sigurimit serb- kumtoi Drejtoria Informative e UÇK-së*

Drejtoria Informative e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës njofton se gjatë javës së fundit në nënzonën operative të Llapit organet policore të UÇK-së kanë ndaluar dhe arrestuar një grup banditësh, të cilët kanë kolaboruar me armikun. Në informacionin e kësaj drejtorie kjo kategori njerëzish është cilësuar si spiunë dhe vjedhës, të cilët në bashkëpunim me punëtorët e specializuar të sigurimit serb kanë vjedhur e plaçkitur popullin shqiptar dhe fshatrat e boshatisura shqiptare.

Njoftohet se është ndalur edhe inspektori i sigurimit serb Goran Iliç i cili ka qenë organizatori kryesor i të gjitha plaçkitjeve të kryera në Llap.

Të gjithë të arrestuarit u janë dorëzuar organeve të hetuesisë, dhe ata po trajtohen nga organet përkatëse.

Në informacion thuhet se kështu do të veprohet edhe në të ardhmen me të gjitha grupet e tjera që në bashkëpunim me UDB-në pengojnë procesin mësimorë, dëmtojnë pyjet dhe kryejnë vepra të tjera në dëm të popullit dhe atdheut.

PËR OSBE-në: USHTRIA E POLICIA SERBE SHQETËSON POPULLATËN CIVILE DHE PENGON KTHIMIN NË SHTËPITË E TYRE

## Nën bodrume e rrënoja që pikojnë pandërprerë

*Banorët janë të rrezikuar nga prezenca dhe provokimet e përhershme të ushtrisë dhe policisë serbe.- Në fshatin Vasilevë, ata pak banorë që janë kthyer s'kanë ushqim për njërëz dhe për kafshë* (faqe 3)

TË SHTUNËN NË KRYEQYTETIN ZVICRAN

## Mbi 10.000 shqiptarë kërkuan njohjen e pavarësisë së Kosovës

(faqe 2)

KONTRIBUTI NË KËTO KOHË I FAMULLISË SË GJAKOVËS

## Me të rrezikuarit e kemi ndarë edhe kafshatën e gojës

(faqe 10)

AKSION URGJENT I "SHOQATËS PËR POPUJT E RREZIKUAR" NË GOTINGEN TË GJERMANISË

## Trupat militare serbe të terhiqen tërësisht nga Kosova

(faqe 6)

REAGIMET E POLITIKANËVE SHQIPTARË PAS PROPOZIMPLANIT MË TË RI SERB RRETH "ZGJIDHJES" SË PROBLEMIT TË KOSOVËS:



## Demaçi: Propozime për të kënaqur apetitet serbe në Kosovë



## Agani: Përpjekje për të legalizuar pushtimin e Kosovës



## Kurteshi: Ofertë joobjektive dhe e parealizueshme


DITURIA Reisebüro
FLUTURIME PËR VENDLINDJE
DÜSELDORF: 0211/ 164 64 06
PRISHTINË: 038/ 26 210

shpejtësi RISI cilësi
FOTO GAGI

cilësi, shpejtësi
NESHA PRISHTINË

OPEL Siqani
- Pjesët rezervë
- Servisimi i automobilave
- Shitja e automobilave
Tel. (038) 524 777, 24 175, 524 140

komtel
project engineering prishtina
KOMPJUTERË SERVIS
Prishtinë, rr.R.Sadiku 34/7
Tel.: 038/ 29610, 29735, 26871

SH.A. SIGURIMI

